

SHOQERIA "NOSHI" SHPK
NUIS J91524007E
TIRANE

V E N D I M

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE

date 14/08/2018

Asambleja e Shoqerise "NOSHI" shpk , e perbere nga ortaket Arian Musa dhe Gazmend Haxhia, u mbledh sot me 14/08/2018, me pjesmarrjen e plote te kapitalit, per te shqyrtuar Akt ekspertimin e Zmadhimit te Kapitalit themeltar te shoqerise.

Mbas njohjes me Akt Ekspertimin e realizuar nga Auditues Ligjor, Vjollca DERVISHI, mbi zmadhimin e Kapitalit themeltar te shoqerise, e caktuar me kete mision me Vendim Asambleje date 06/08/2018, asambleja



vendosi:

1. Të Miratojë Akt Ekspertimin e realizuar nga Auditues Ligjor Vjollca DERVISHI, mbi zmadhimin e Kapitalit të shoqërisë, **nëpërmjet kontributit në natyrë**, të shprehur në para sipas Kontratës së blerjes së truallit dhe Çertifikatës së Pronësisë së lëshuar për të nga Zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.
2. Të Miratojë Zmadhimin e Kapitalit, me përfshirjen e kontributeve në natyrë prej **7 095 000 leke**, duke e çuar Kapitalin në vlerën e **95 745 000 leke**, i ndarë në 2 kuota kapitali, në favor të:
 - Arian Musa është zotërues i 1 kuote kapitali ose 66 % e vlerës absolute të kapitalit e barabartë me 63 191 700 lekë.
 - Gazmend Haxhia është zotërues i 1 kuote kapitali ose 34 % e vlerës absolute të kapitalit e barabartë me 32 553 300 lekë.
3. Të kërkojë depozitimin e Vendimeve të Asamblesë dhe të Akt Ekspertimit të Zmadhimit të Kapitalit, pranë Zyrës së regjistrimit të pasurisë së Paluajtshme për të bërë tjetërsimin e zotëruesit të pronës nga Arian Musa dhe "NOSHI" SHPK vetëm te "NOSHI" SHPK.
4. Të kërkojë depozitimin e këtij Vendimi dhe të Akt Ekspertimit të Zmadhimit të Kapitalit, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë

ORTAKET E SHOQERISE

Arian Musa

Gazmend Haxhia



NOSHI SH.P.K.
SHITJE MAKINA, PJESE, SERVIS
KASHAR - TIRANE

SHOQERIA "NOSHI" SHPK

J91524007E

TIRANE

V E N D I M

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE

date 06/08/2018

Asambleja e ortakeve te Shoqerise "NOSHI" shpk , e perbere nga ortaket e saj, Arian Musa dhe Gazmend Haxhia u mblodh sot me 06/08/2018 , me pjesmarrjen e plote te kapitalit, per te shqyrtuar situaten financiare te shoqerise dhe mundesine e Zmadhimit te Kapitalit themeltar te shoqerise.Pasi mori ne analize situaten ekonomike te shoqerise si dhe vendimet e meparshme, Asambleja shqyrtoi ;

Përfshirjen e Sipërfaqesë së truallit mbi të cilën është ngritur objekti "Ndërtesa e oborr rretheqark saj" i shoqërisë "NOSHI" SHPK në pasurinë e shoqërisë nëpërmjet kapitalizimit të vlerës së saj në Kapitalin e nënshkruar të shoqërisë.

Kjo pasuri është në emër të ortakut Arian Musa dhe deri tani është evidentuar në Pasqyrat financiare të shoqërisë nën emërtimin "Aktive në përdorim" për arsye të përdorimit të saj nga shoqëria.

Ortaku Arian Musa deklaron se, pasurinë e përbërë nga 5000 m2 truall e vërtetuar me Çertifikatë pronësie nr 442349 me datë lëshimi 03/12//2009 , dëshëron t'ia bashkangjisë pasurisë së shoqërisë "NOSHI" SHPK si Kontributë në natyrë në rritje të kapitalit të shoqërisë, por pa ndryshuar përqindjet e seicilit prej ortakëve në pjesmarrjen në kapital.

Bazuar në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Neni 73 Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave 1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

ATËHERE

Asambleja gjykoi me vend mbrojtjen e shëndetit ekonomik e financiar të shoqërisë duke përfshirë në pasuritë e saj truallin mbi të cilën kryen aktivitetin, përkundrejt zmadhimit të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë me vlerën e blerjes së truallit, dhe

vendosi:

1. Të shpreh kuotat e kapitalit të shoqërisë në bazë të ndryshimeve ligjore , dhe konkretisht :

Kuotat **ishin 88650 pjesë** në zotërim të ortakëve ;Arian Musa 58 509 pjesë ose 66 % e vlerës absolute të kapitalit dhe Gazmend Haxhia 30141pjesë ose 34 % e vlerës absolute të kapitalit,

dhe **bëhen 2 kuota** në zotërim të ortakëve:


1/2

- **Arian Musa** zotëron **një kuotë** të barabartë me 58 509 000 lekë ose **66% e vlerës absolute të kapitalit të shoqërisë.**
 - **Gazmend Haxhia** zotëron **një kuotë** të barabartë me 30 141 000 lekë ose **34% e vlerës absolute të kapitalit të shoqërisë.**
2. Te Zmadhoj Kapitalin themeltar te shoqerise, **nëpërmjet kontributit në natyrë**, të shprehur në para sipas Kontratës së blerjes së truallit dhe Çertifikatës së Pronësisë së lëshuar për të nga Zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme.
 3. Të kërkoj caktimin e Auditues Ligjor Vjollca DERVISHI, me License profesionale nr 39 datë 13.01.2000 , NIPT K31424141F, karte identiteti nr 033491200 dhe nr personal G45807115C , për të verifikuar vlerën e kontributeve dhe procedurat e Zmadhimit të Kapitalit themeltar.
 4. Të kërkojë depozitimin e këtij Vendimi, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit , Tiranë.

ORTAKËT E SHOQËRISË

Arian Musa

Gazmend Haxhia



NOSHI SH.P.K.
SHITJE MAKINA, PJESE, SERVIS
KASHAR - TIRANE